



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

NJOFTIM  
PËR MBLEDHJE PLENARE  
30 nëntor 2023

Informacion mbi mbledhjen:

Dita/Data:	E enjte, 30.11.2023
Ora:	10.00
Kohëzgjatja:	~ 120 min
Thirrur nga:	Kryetari i Këshillit
Pjesëmarrësit:	Anëtarët
Kuorumi i nevojshëm:	7 anëtarë

*Kjo mbledhje do të organizohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit, në prezencë të Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe të ftuar përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, Prokurori i Përgjithshëm dhe Programi OPDAT dhe EU4JUSTICE. Media si gjithmonë është e ftuar të jetë e pranishme.*

Rendi i ditës:

1. Diskutimi/miratimi i procesverbaleve të Seancave Plenare të datave 27.10.2023 dhe 13.11.2023.
2. Diskutimi/ miratimi projektaktit për *“Caktimin e shkallës së vlerësimit për kandidatët për prokuror në prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”*;
3. Diskutimi/miratimi i projektaktit *“Për caktimin në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për pozicionin e shpallur vakant Nr.1, me vendimin Nr.319, datë 20.10.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas procedurës së lëvizjes paralele”*;
4. Diskutimi/miratimi i projektaktit *“Për caktimin në detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, për pozicionin e shpallur vakant Nr.2, me vendimin Nr.319, datë 20.10.2023 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, sipas procedurës së lëvizjes paralele”*;
5. Diskutimi/miratimi i projektaktit *“Për komandimin e prokurorit në pozicionin e Këshilltarit Ligjor pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë”*;
6. Diskutimi/miratimi i projektaktit *“Për miratimin e opinioneve për kandidatët që kanë aplikuar në procedurën e komandimit të një prokurori si ndihmësmagjistrat pranë Prokurorisë së Përgjithshëm”*;
7. Diskutimi/miratimi i projektaktit për *“Një ndryshim në vendimin Nr.289, datë 17.07.2023 për “Praktikën profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës”*;

8. Diskutimi/miratimi i projektaktit mbi *“Kërkesën e prokurores Enkeleda Millonai për ushtrim të veprimtarisë jashtë funksionit”*;
9. Diskutimi/miratimi i projektaktit *“Për ri-llogaritjen e pagave për anëtarët dhe ish-anëtarët e KLP-së, për periudhën 08.05.2021-08.01.2023”*;
10. Diskutimi/miratimi i projektaktit *“Për miratimin e programit që përcakton listën e prokurorëve, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit 2024”*;
11. Diskutimi/miratimi i Rregullores për *“Vlerësimin etik dhe profesionale të drejtuesve të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm”*;
12. Diskutimi/miratimi i projektaktit mbi *“Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatit për Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024, zotit Raklent Çami”*;
13. Diskutimi/miratimi i projektaktit mbi *“Mbi verifikimin e pasurisë dhe figurës të kandidatit për Programin e Formimit Fillestar të Shkollës së Magjistraturës në vitin akademik 2023-2024, zotit Edikel Bregasi”*;
14. Diskutimi/miratimi i projektaktit mbi *“Miratimin e listës pjesore të kandidatëve për student në Shkollën e Magjistraturës për vitin akademik 2023-2024;*
15. Diskutimi/ miratimi i projektaktit për *“Caktimin me short të relatorit dhe këshilltarit ligjor përgjegjës për procedurën e vlerësimit të prokurorëve Kreshnik Ajazi, Anita Jella dhe Genti Xholi”*;
16. Diskutimi/ miratimi i Rregullores *“Për caktimin e procedurës dhe masës së trajtimit financiar të prokurorit për shërbimin në skemën e delegimit, për transferimin e përkohshëm, për caktimin e përkohshëm dhe caktimin për një çështje të veçantë”*.

**Të tjera (pyetje/diskutime).**

- *Diskutim mbi kërkesën për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të paraqitur nga magjistrate Pranvera Gruda;*
- *Diskutim mbi nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Komisionin e Prokurimit Publik.*

Urdhërohet sektori i dokumentimit të seancave të bëj publikimin e kësaj axhende në faqen web të Këshillit.

Njoftohen të gjithë anëtarët e Këshillit për të siguruar pjesëmarrjen

**Kryetar**

**Alfred Balla**